

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'TASK FORCE' -
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919777/rama-i-izoluar-nderkombetarisht-zhulali-pa-takime-n-e-okb-skandali-i-shish-nuk-eshte-individual/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:16:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:50:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5d2c4fe560c157c9610bdeb5c5e9a9fde0ba7a6d7134b4d92e719e84db970da8
TEKSTI	b691149f32bea66e5bb296ab054c370b15aaba84d19d8b62fb2e0b6c734cf6d3
PAMJA	ed7a572b73966bc620562ac4a5dfa9d78f4e83dd36f6c3256bb62ab836ce8c34

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cef59d6629dc51008e0caad2417e8b1d555bc3d3fe4f0fd4cda8404616735cbf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cef59d6629dc51008e0caad2417e8b1d555bc3d3fe4f0fd4cda8404616735cbf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEÇA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk i kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?

Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



'Rama i izoluar ndërkombëtarisht', Zhulali: Pa takime në OKB, skandali i SHISH nuk është individual

18:50, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



E ftuar në emisionin 'TASK FORCE' me Sonila Meçon, Drejtuesja e Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë në PD, Ilda Zhulali, deklaroi se Edi Rama ndodhet në "ditët e veta më të errëta", duke e lidhur situatën me vizitën e fundit të kryeministrit në OKB.

Zhulali tha se Rama nuk zhvilloi asnjë takim gjatë qëndrimit në Nju Jork dhe e cilësoi këtë si shenjë të izolimit të tij ndërkombëtar.

Ajo hodhi gjithashtu dyshime mbi kohën e publikimit të çështjes që lidhet me drejtoreshën e SHISH, Vlorë Hyseni, duke pretenduar se bëhet fjalë për një operacion të koordinuar për të diskredituar dhe dobësuar politikisht Ramën dhe Hysenin.

Zhulali kritikoi ashpër edhe qëndrimin e institucioneve shqiptare ndaj çështjes së SHISH.

Ajo theksoi se Presidenti Bajram Begaj dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare po e trajtojnë si çështje individuale një problem që prek një institucion të sigurisë kombëtare.

"Si mundet Presidenti i Republikës deri në këtë pikë sa një skandal me të tilla përmasa, që përfshin një institucion të tërë, që është SHISH-i, ta trajtojë si një çështje individi?", tha ajo.

Zhulali paralajmëroi gjithashtu se partnerët ndërkombëtarë mund të kenë kufizuar shkëmbimin e informacionit të klasifikuar me Shqipërinë, duke argumentuar se një situatë e tillë do të cenonte besueshmërinë e vendit në marrëdhëniet me shërbimet partnere.

Pjesë nga intervista:

Unë mendoj që ai realisht sot është në ditët e veta më të errëta. Të mos harrojmë që çdo vullthi pas OKB, ku nuk eriti dot të realizo...



mos marrimë që japo u kërçe nga OKB, ka nuk arriti dot të realizojë as edhe një takim. Po të shikoni ndër vite, çdo herë që ka qenë, qoftë kryeministër, qoftë president, kushdo që ka patur mundësinë të shkojë në OKB, ka zhvilluar një minimum takimesh. Edhe Bajram Begaj kur ka qenë, që është mendoj unë figura politike me profilin më të ulët në historinë politike të Shqipërisë që ka përfaqësuar atë institucion, ka patur një minimum takimesh, dhe këtë nuk e ka arritur dot as Edi Rama.

Të mos ta krahasojmë pastaj me homologë të tij nga rajoni, të cilët kanë zhvilluar takime shumë të rëndësishme, edhe për shkak të zhvillimeve shumë të rëndësishme ndërkombëtare dhe për shkak të diskutimeve që kanë vendet, qoftë në aspektin dypalësh, qoftë për çfarë po ndodh në kuptimin e sigurisë. Vetëm Edi Rama ka qenë i vetmi në rajon vetmi në rajon që shkoi deri në Amerikë, shkoi në OKB, pra ky ishte misioni se për çfarë shkoi ai atje, dhe nuk realizoi asnjë takim. Pra, ishte totalisht i izoluar ndërkombëtarisht. Dhe unë nuk mendoj që qenia e tij atje-atje ka qenë rastësi me përkimet e lajmit për Vlorë Hysenin. Mendoj që ky ka qenë një operacion i koordinuar enkas për t'i diskredituar të dy publikisht, botërisht, edhe Vlorë Hysenin atje ku ishte, me shefat e shërbimeve të 82 vendeve të botës, po ashtu edhe Edi Ramën.

Patjetër, dhe fakti që u bë... sepse Vlorë Hyseni të gjitha veprimet nuk është se i kishte bërë vetëm një ditë përpara se të ikte nga Shqipëria. Pra, për të kishte dijeni të plotë se çfarë kishte bërë, mund t'i ishte ndaluar për të shkuar atje, ose mund të pritej që të vinte që atje. Por mendoj që është përzgjedhur enkas kjo kohë kur të dy kanë qenë në dy takime të këtij formati, për t'i delegjitimuar, jo vetëm diskredituar politikisht, por edhe për t'i delegjitimuar dhe për t'u dobësuar pushtetin në maksimumin e mundshëm. Tani ky është Edi Rama që erdhi i tillë, i zvarritur nga OKB-ja në Tiranë, u përpoq që të jepte ndonjë lajm dhe të ngrinte pritshmëritë e njerëzve sikur do të jepte dorëheqjen, duke harruar pjesën më të madhe që kanë të bëjnë me të njëjtin Edi Ramë që ishte para se të shkonte në OKB, ai nuk ndryshon.

Dhe ai nuk e njeh konceptin e normalitetit, e dinjitetit të institucionit, apo që të ndjejë një mea culpa, ëh, të bëjë një apologji ndaj qytetarëve shqiptarë për çfarë u ka bërë gjatë gjithë këtyre viteve. Aq më pak me këtë që po përploqet që ta trajtojë si një çështje individuale. Dhe ishte e turpshme sot për shembull, që të shikoje që të njëjtin narrativë përdorte dhe Presidenti i Republikës, Bajram Begaj. Që ai këshilli i mbledhur sot aty meriton të quhet çdo gjë përveç Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Ai mund të jetë këshilli i miqve të gjyshit, këshilli i pasigurisë kombëtare, këshilli i krimit, çdo gjë, po vetëm i sigurisë kombëtare s'mund të quhet. Dhe narrativa e përdorur, ekzaktësisht ajo që kërkonte Edi Rama, e bën atë akoma më të turpshme, duke e paraqitur këtë njerëzve si një çështje individuale. Si mundet të arrijë Presidenti i Republikës deri në këtë pikë sa një skandal me të tilla përmasa, që përfshin një institucion të tërë, që është si SHISH-i, pra që është i sigurisë, që është bazamenti i shtetit, ëh, ta trajtojë si një çështje dashuriçke, ëh, si një çështje individi.

Për të aktualitetit, po, se do të dilja edhe aty. Por e trajton si çështje individuale. Ndërkohë që ne jemi në pikën që sot që flasim, unë besoj që të gjitha vendet partnere kanë marrë masa që të mos e ndajnë informacionin e klasifikuar me Shqipërinë, siç kanë bërë deri dje.

Këto nuk mund të reagojnë publikisht, por unë do të jap një rast përpara disa vitesh. Pati një ngjarje në Austri, që përfshinte shërbimin inteligjent. Menjëherë vendet partnere, po flasim për Austrinë ëh, që ka një tjetër kulturë institucionale dhe gjëma të këtij lloji do e kishin rrëzuar qeverinë 700 herë deri tani. Dhe jo vetëm. Por aty u morën menjëherë masa, u kufizua ndarja e informacionit të klasifikuar, sa Austria u detyrua që ta ringrinte institucionin nga e para. Po ju kujtoj gjithashtu dëmin që bëri Charles McGonigal, nëse e mbani mend, kreu i FBI-së pasi doli çështja e tij, tha që dëmi që i është bërë institucionit është i pallogaritshëm.

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

© SYRI.net


Lexo edhe:



Dita e 121-të e protestës, nis marshimi i qytetarëve drejt Kryeministrit: Rama, jepe dorëheqjen!



VIDEO-'Ora 400 mijë euro dhe skandali i SHISH'/ Çollaku:



Edi Rama e di çfarë do të dalë nga dosjet



'Rama varrosi për së gjalli Belerin'// Burimi: Rama dosjen e Berishës e çoi në media. Kërcënoi BE me rusët e kinezët

TË NGJASHME



'Nuk ka kthim pas!'/ 121 ditë protesta, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Edi Ramës



Belshi refuzon shkrirjen me Elbasanin, PD voton kundër, PS abstenon në Këshill



'Gjithçka pjesë e një skeme me bekimin e Ramës', Boçi: Informacioni është pushtet



Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga 'republika e prokurorëve', por nga republika e të korruptuarve



'Narkoshteti' pengon integrimin', Gjekmarkaj: Shqipëria nuk shkon në Europë me deklarata, por me reforma reale



Kur Rama prek themelet e 'familjes' europiane



Këshilli i Sigurisë Kombëtare, Logu: Aty më shumë ishin mbledhur çunat e Gysit me çunat e Ronit...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MEDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.